



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 3793 Prot.

Patos, më 18/10/2024



MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 75, datë 18/10/2024

PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRDITËSUAR TË KUFIJVE
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE PËR BASHKINË PATOS

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të nenit 54, 55, 93, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, VKM nr. 360, datë 29.5.2019, “Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, vendimi nr. 1078, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Dokumentit “Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri”. Tema - Kufijtë e Njësive Administrative” dhe shkresës ASIG me nr. 647 prot., datë 11/10/2024 i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Patos:

1. Të miratojë “Hartën e përditësuar të kufijve administrativo-territoriale”, për Bashkinë Patos, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

GRUPI I PUNËS

Boreta Murati

Marsilda Lizaj

Françeska Gjata

JURISTE

Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHqipërisë

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 3793 Prot.
12

Patos, më 18/10/2024

RELACION

**PËR MIRATIMIN E HARTËS SË PËRDITESUAR TË KUFIJVE
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE PËR BASHKINË PATOS**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Pranë Bashkisë Patos është paraqitur kërkesa e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor ku kërkohet harta e përditësuar e kufijve administrativo-territorial, që përcakton standardet gjeohapësinore në kuptim të pikës 2, të nenit 93, të ligjit nr. 139/2015, i cili parashikon 5 rinde kufijsh administrativo-territoriale.

Si nevojë për të patur një hartë të përditësuar të kufijve ndarës administrativo-territorial, kemi punuar hartën për njësitë administrative (rendi 4) dhe fshatrave apo njësi të tjera në përbërje (rendi 5).

Hartat e përgatitura nga ana jonë për secilën njësi administrative të Bashkisë Patos konkretisht:

1. Njësia Administrative Patos
2. Njësia Administrative Zharrëz
3. Njësia Administrative Ruzhdie


Kufiri i paraqitur është sipas hartave të përditësuara që ne disponojmë, për zona ende të pa azhornuara kufiri mund të jetë i ndryshueshëm.

HARTE TREGUESE
BASHKIA PATOS



Në hartën e mësipërme kemi paraqitur hartën e bashkisë Patoš ku janë të pasqyruara fshatrat me zonat kadastrale përkatëse dhe kufiri i ri është i paraqitur me ngjyrë blu dhe kufiri i vjetër me ngjyrë të kuqe


Kufiri i njësisë sipas Zonave Kadastrale.



Në hartën e mësipërme është paraqitur kufiri i Njësisë Administrative Patos në të cilën përfshihet: qyteti i Patosit (Zk 2890), fshati Dukas (zk 1567), fshati Kuqar (zk 2329), fshati Grizë (zk 2411), fshati Banaj (zk 1094), fshati Rreres (zk 3172), fshati Rusinjë (zk 2349), fshati Marglliç (zk 2594).

Në fshatin Rreres, Rusinjë dhe Marglliç nuk ka kaluar ende procesi i regjistrimit fillestar dhe kufiri i paraqitur mund të jetë i ndryshueshëm në momentin e azhurnimit.


Kufiri i njësisë sipas Zonave Kadastrale.



Në hartën e mësipërme është paraqitur kufiri i Njësisë Administrative Zharrëz në të cilën përfshihet: fshati Zharrëz (zk 3922), fshati Verbas(zk 1743), fshati Frashër (zk 1638), fshati Sheqishtë (zk 3361), fshati Belinë (zk 1142).


Për Fshatin Zharrëz disponojmë kufirin e përditësuar i paraqitur si më poshtë:

Kufiri i përditësuar për fshatin Zharrëz:



Kufiri i vjetër i fshatit Zharrëz është i paraqitur me ngjyrë blu dhe kufiri i ri i paraqitur me ngjyrë të kuqe.

Kufiri i njësisë sipas Zonave Kadastrale.



Në hartën e mësipërme është paraqitur kufiri i Njësisë Administrative Ruzhdie në të cilën përfshihet: fshati Ruzhdie (zk 3250), fshati Gjinoqarë (zk 1773), fshati Drenie (zk 1537), fshati Siqecë (zk 3457), fshati Kasnicë (zk 2111).

Për fshatin Siqecë dhe Kasnicë nuk ka kaluar ende procesi i rregjistrimit fillestar dhe kufiri i paraqitur mund të jetë i ndryshueshëm në momentin e azhurnimit

HARTE TREGUESE
BASHKIA PATOS



Harta e përditësuar e ndarjes administrativo-territoriale, të njësive administrative për Bashkinë Patos, duke qenë në kushtet që kemi ende zona të pa azhornuara të cilat ndodhen në kufirin ndarës me bashki të tjera kufiri aktual mund të pësojë ndryshime.

Për sa më sipër, i kërkojmë këshillit bashkiak miratimin e hartës së përditësuar të ndarjes administrativo-territoriale, për rendin 4 dhe rendin 5.

GRUPI I PUNËS

Boreta Murati

Marsilda Lizaj

Françeska Gjata

KRYETAR
Fation Duro



